



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 06.07.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për emërimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ)

- I. Miratohet rekomandimi i Këshillit të Personelit të KQZ-së i datës 02.07.2009 për emërimin e anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 në Republikën e Kosovës.
- II. Regjistri i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve sipas komunave të poshtëshënuara është pjesë përbërëse e këtij vendimi:

Deqan, Gjakovë, Gllogovc, Gjilan, Dragash, Istog, Junik, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skënderaj, Shtime, Shterpcë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Han i Elezit dhe Mamushë.
- III. Mandati i KKZ-së do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të mandatit ose zgjatet me vendim të veçantë të KQZ-së.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datë 6 korrik 2009.

Prishtinë, 6 korrik 2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

